



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKË E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 20/06/2019

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “AZ Trading” shpk me NUIS L81515016F dhe me adresë:
Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-23708-05-24-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “ Blerje kamion 4 aks” afati: 20 (njëzetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomiksht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 21, Date 27.05.2019.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Shoqëria “AZ Trading” shpk me NUIS L81515016F dhe me vlerë 5.099.000 (pesë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë) leke pa TVSH.
2. Shoqëria “LIGUS” shpk me NUIS L51523001S dhe me vlerë 3.150.000 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “LIGUS” shpk me NUIS L51523001S.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Nuk përmbush pikën 2.2.3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar ku thuhet se “OE duhet të dorëzojë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.” pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e kërkuar për vitin 2019, por vetëm për vitin 2018.
- b) Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku thuhet se “Operatori ekonomik duhet të deklarojë llojin e mjetit, të shoqëruar me foto dhe me leje

qarkullimi/libreze mjeti, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen edhe kilometrat e përshkuara të mjetit, të shoqëruar edhe me foto të treguesit të kilometrazhit në kroskot."pasi nuk ka paraqitur leje qarkullimi/librezë mjeti në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

- c) Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku thuhet se "*Operatori Ekonomik duhet të disponoj ose të paraqesi kontratë noteriale bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të reparteve të punës.*"pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik "AZ Trading" shpk me NUIS L81515016F** dhe me adresë: Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **5.099.000** (pesë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 12.06.2019.

Ankesa: Nuk ka.